



Prenjari / Dorezuar Puniljeno/Prodato Received/Delivered	11.12.2023	3	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKUMSHAK	7382	2023	1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHTI BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1202/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit me numër AA.nr.1649/2021, të datës 14.09.2023, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A.nr.419/2021, të datës 14.05.2021 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 11.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.419/2021 e datës 14.05.2021, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ndaj ankuesit i cili ka qenë i punësuar në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës sipas Akt emërimit të datës 27.12.2011 me numër të referencës 03/112-274 në vendin e punës "Përkthyes shqip/serbisht dhe anasjelltas", Drejtori i Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës me datën 20.03.2020 ka nxjerr vendim me numër të reference DS-156/2020 lidhur me përfundimin e marrëdhënies së punës nga data 06.04.2020 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, duke i njohur të drejtën e kompensimit të një (1) pagë mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit.

Ankuesi me datë 08.01.2021 parashtron ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me pretendim ankimor se me rastin e pensionimit duke u bazuar në Ligjin e Punës dhe Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës sipas nenit 52 dhe 53 i takojnë dy paga mujore jubilarë si dhe dy paga përcjellëse

me rastin e pensionimit. Komision për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave me datë 20.01.2021 nxjerr Vendim me numër KA.nr.07/2021 me të cilin vendim refuzohet si e pa bazuar ankesa e ankuesit.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin e Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me datë 14.05.2021 nëpërmjet përfaqësueses së tij parashtron ankesën me numër protokollit 2397/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 19.05.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit në Gjykatën e Apelit të Kosovës. Më datë 21.05.2021, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Gjykata e Apelit të Kosovës me provat e bashkangjitura faqe 1/7. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me date 28.06.2021 ka nxjerr Vendimin me numër A.nr.419/2021 me të cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar.

Ankuesi i pa kënaqur me Vendimin me numër A.nr.419/2021 të datës 28.06.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datë 23.07.2021 ka ka iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, ndërsa kjo e fundit përmes Aktgjykimit me numër A.nr.1649/2021 të datës 05.09.2022 ka refuzuar padinë e paditësit i cili ka kërkuar që të anulohet vendimi me numër A.nr.419/2021 të datës 28.06.2021 të Këshillit.

Ankuesi i pa kënaqur me Aktgjykimin me numër A.nr.1649/2021 të datës 05.09.2022, me date 14.09.2022, përmes Gjykatës Themelore ne Prishtine/ Departamenti për Çështje Administrative ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës.

Gjykata e Apelit te Kosovës me date 30.05.2023 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër AA.nr.749/2022 me të cilin e ka anuluar Aktgjykimin me numër A.nr.1649/2021 të Gjykatës Themelore ne Prishtine/Departamenti për Çështje Administrative dhe e ka kthyer çështjen e ankuesit në rishqyrtim dhe rivendosje me arsyetim se është dashur të kërkohet dëshmi- prova nga paditësi për përvojën e punës të punëdhënësi i fundit në drejtim të pagave jubilarë dhe pas vlerësimit të tyre të vendos për objektin e kërkesëpadisë se paditësit. Ndërsa Gjykata Themelore në Prishtine/Departamenti për Çështje Administrative ne rishqyrtim dhe rivendosje me datë 14.09.2023 ka nxjerr Aktgjykim me numër A.nr.1649/2021 përmes së cilës ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit duke e anuluar Vendimin me numër A.nr.419/2021 të datës 28.06.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil te Kosovës dhe e ka kthyer çështjen e ankuesit në rishqyrtim dhe rivendosje me arsyetim se organi i paditur respektivisht Këshilli Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk e ka trajtuar fare pretendimin e paditësit për pagat jubilarë te cilat ankuesi pretendon se i takojnë konform nenit 22 paragrafi 2 nen paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë.

Administrimi i Provave: Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër A.nr.1649/2021 të datës 14.09.2023 të Gjykatës Themelore ne Prishtine; Procesverbalin e datës 14.09.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinës; Autorizimin e datës 13.09.2023; Aktgjykimin me numër 1649/2021 të datës 05.09.2022; Aktvendimin me numër AA.nr.749/2022 të datës 30.05.2023 të Gjykatës së Apelit të Kosovës; Padinë e datës 14.09.2022; Përgjigjenin në padi të datës 05.07.2022; Aktvendimin me numër A.nr.1649/2021 te datës 22.06.2022 te Gjykatës Themelore ne



Prishtinë/Departamenti pre Çështje Administrative; Padinë e datës 20.07.2021; Kërkesën e datës 08.01.2021 të parashtruar nga ankuesi në Gjykatën e Apelit në Prishtinë; Shkresën e datës 05.05.2021; Vendimin me numër A.nr.419/2021 të datës 28.06.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin me numër 03/313 të datës 20.03.2020; Vendimin e datës 20.01.2021; Ankesa e ankuesit e datës 14.05.2021 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimi i Avokates i datës 23.12.2020; Vendimi për përfundimin e marrëdhënies së punës i datës 20.03.2020; Vendimi i datës 20.01.2021 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Ankesa e ankuesit e parashtruar në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave; Konfirmimi për pranim të Vendimit të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i datës 05.05.2021; Akt emërimi i ankuesit i datës 27.12.2011; Urdhër obligimi i pagesës si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkangjitura të lëndës faqe 1/7.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka vërtetuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar,*
sepse:

Sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1649/2021 të datës 14.09.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative në të cilin është theksuar se nuk janë shqyrtuar pretendimet e ankuesit sipas kërkesës së tij respektivisht kompensimi i pagave jubilarë sipas nenit 22 paragrafi 2 nënparagrafi 2.2 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civil. Këshilli pas rishqyrtimit të ankesës sipas Aktgjykimit të lartpërmendur ka konstatuar se ankuesit sipas Vendimit me numër të reference DS-156/2020 të datës 20.03.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga data 06.04.2020 i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, dhe po ashtu i është njohur edhe kompensimi i një (1) pagë mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit.

Tutje Kolegji i Këshillit pas analizimit të Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 14.09.2023 e cila ka obliguar Këshillin që konform nenit 132 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative duhet që të shqyrtoj përsëri ankesën e ankuesit vetëm sa i përket kërkesës se kompensimit të pagave jubilarë por jo edhe pretendimet tjera. Andaj pas analizimit të pretendimit lidhur me kompensimin e dy pagave jubilarë siç kërkon ankuesi në ankesën e datës 14.05.2021 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës e cila duke u bazuar në nenin 52 të Marrëveshjes Kolektive të Kosovës kërkon kompensimin e dy (2) paga jubilarë, e cila përcakton se; *i punësuari, ka të drejtë në shpërblimin jubilar dhe atë: 1.1.për 10 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të një page mujore të tij; 1.2.për 20 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të dy paga mujore të tij; 1.3.për 30 vjet të përvojës në punë pandërprerë, të punëdhënësi i fundit, në vlerë të tri paga mujore të tij,* Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ky pretendim është i pa bazuar sepse sipas dëshmisë respektivisht e-mailit të datës 31.10.2023, të dërguar në Këshill nga Menaxherja e Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës është theksuar se ankuesi marrëdhënien e punës e ka themeluar sipas Akt emërimit të datës 27.12.2011 në vendin e punës "Përkthyes shqip/serbisht dhe anasjelltas", në Gjykatën e Qarkut tani Gjykata e Apelit, ndërsa sipas Vendimit të datës 20.03.2020 ankuesit i ka përfunduar marrëdhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, gjegjësisht me datën 06.04.2020 ankuesi është pensionuar dhe se nuk ka arritur dhjetë(10) vjetorin për t'ju kompensuar paga jubilarë, ashtu siç është paraparë edhe me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafin 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil pasi që ankuesi



për të marr një pagë jubilarë është dashur të jetë në marrëdhënie punë deri në vitin 2021 respektivisht i njëjti nuk ka arritur dhjete (10) vite pune pa ndërprerë ashtu siç është parapare edhe me nenin 21 të Rregullores Nr. 33/12 per Shtesat ne Page dhe Kompensime të Tjera i cila ka përcaktuar se,, *Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune*”. Andaj duke pasur parasysh dispozitat e lartcekura Kolegji ka konstatuar se ankuesi nuk ka arritur gjithsej 10 vite përvoje pune nga themelimi i marrëdhënies se punës deri tek përfundimi per shkak të arritjes se moshës së pensionimit, pasi që i njëjti ka gjithsejtë 8 vite e katër (4) muaj përvoje pune, andaj pretendimi i ankuesit është i pa bazuar.

Po ashtu, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, sipas Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë të datës 14.09.2023 ka rishqyrtuar pretendimin ankimor të ankuesit i cili pretendon sipas Ligjit të Punës Nr.03/L-212 si dhe dispozitave të nenit 52 dhe 53 të Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës i takojnë dy paga jubilarë si dhe dy paga përcjellëse me rastin e pensionimit, dhe ka konstatuar se pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar, sepse për kompensimet e nëpunësve civilë ne ate kohe kanë qene të aplikueshme dispozitat ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe aktet tjera nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe në bazë të këtij ligji nëpunësve civilë me rastin e pensionimit ju takon kompensimi në vlerën e një page të njëhershme të pagës së fundit, e jo dy (2) pagave siç ankuesi pretendon, e kjo është e përcaktuar me dispozitat ligjore të nenit 22 paragrafi 2 nën paragrafin 2.2 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë që nëpunësi civil ka të drejtë të kompensohet me rastin e pensionimit dhe të dispozitave të nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, që përcakton se: **“1. Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit. 2. Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit”**.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës ka hyrë në fuqi më datë 01.01.2015 sipas nenit 82 të saj, ndërsa ka pasur një kohëzgjatje prej tri vitesh siç parashihet me dispozitat e nenit 90 paragrafit 4 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, përcaktohet që: **“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet”**, mirëpo neni 81 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, respektivisht paragrafi 1 ka përcaktuar që: **“Nga MPKK, Palët mund të tërhiqen tre (3) muaj para skadimit të vlefshmërisë së saj, përmes letrës rekomanduese. Tërheqja nga kjo MPKK, shpallet në Gazetën Zyrtare të Kosovës”**, bazuar në këtë Oda Ekonomike e Kosovës si nënshkruese e kësaj marrëveshje më datë 15.09.2017 ka njoftuar Ministrin e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale se për arsye ligjore tërhiqet nga zbatimi i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive. Neni 82 paragrafi 2 i Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës përcakton se: **“Nëse nga MPKK, pasi që i skadon afati i përcaktuar, nuk tërhiqet asnjëra nga Palët, zbatimi i saj vazhdon edhe për një vit”**, mirëpo meqenëse njëri nga nënshkruesit e kësaj marrëveshje është tërheq nga zbatimi i saj tre muaj para skadimit e njëjta nuk vlen nga data e tërheqjes, dhe meqenëse konstatohet se nga data 15.09.2017 Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, është tërhequr andaj Kontrata e Përgjithshme Kolektive e Kosovës nuk është e zbatueshme, rrjedhimisht nuk mund të prodhojë asnjë pasojë juridike sepse nuk është nënshkruar nga institucionet kompetente, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes se Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017. Andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e

ankesave, ka konstatuar se ankuesit marrëdhënia e punës së me rastin e pensionimit e ka përfunduar sipas Vendimit të datës 20.03.2020 të Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 20.03.2020 me numër të referencës DS-156/2020 për përfundimin e marrëdhënies së punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit për ankuesin _____ si dhe kompensimin e një page pas moshës së pensionimit, për nëpunësin civil _____ është i ligjshëm dhe i drejtë sepse është marrë në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë si dhe Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i aplikueshëm në atë kohe.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkrësive të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.1202/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Zyrtarë e lartë për bashkëpunim profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Sekretariatit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Gjykatën e Apelit të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.